



STATUTI

I SHOQERISE TREGETARE « BANKA E TIRANES » SH.A.

Pjestaret e krijimit te shoqerise tregtare «**Banka e Tiranes**» te mbledhur sot me 20 Tetor 1995, bazuar ne ligjin « Per shoqerite Tregtare» Nr. 7638 date 19.11.1992, he Ligjin «Per rregjistrimin e shoqerive tregtare» Nr. 7667 date 28.01.1993, si dhe Ligjin Nr. 7560 date 28.04.1992 « Per sistemin bankar ne Shqiperi» vendosen themelimin e shoqerise « Banka e Tiranes».

KAPITULLI I

KRIJIMI - FORMA - KOHEZGJATJA - EMERTIMI OBJEKTI - KAPITALI THEMELTAR

Neni 1

Ortaket themelues te shoqerise jane :

1. Piraeus finance - perfaqesuar nga z. Michail Salas (i cili perfaqesohet nga z. Nikolaos Daouis Remantas, sipas prokures me nr. 29651 rep., date 1.11.1995 te redaktuar nga Noteri i Athines : Vassilios Chronis).

2. **Bank of Piraeus** - perfaqesuar nga z. Michail Salas (i cili perfaqesohet nga z. Nikolaos Daouis Remantas, sipas prokures me nr. 29652 rep. , date 1.11.1995 te redaktuar nga Noteri i Athines: Vasilios Hronis).

3- **Unico Corp.** - perfaqesuar nga z. Nikolaos Daouis Remantas
Nr pass H 367626

Vendosen krijimin e shoqerise anonime me emertimin «Banka e Tiranes Sh.A. - Bank of Tirana S.A. »



Neni 2

%jjF Sella e bankes si dhe adresa e saj ligjore do te jete ne Tirane. Me vendim te Keshillit Drejtues mund te hapen zyra, filile, sherbime dhe agjenci ne te gjithe teritorin e Shqiperise si dhe jashte teritorit te Shqiperise, me vendim miratues te Bankes se Shqiperise.

Nen/3

Kohezgjatja e Bankes percaktohet ne baze te ketij statuti ne 50 vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit te saj ne Gjykate. Shoqeria mund te prishet edhe para se te mbaroje periudha 50 vjecare ose te shtyhet kohezgjatja e saj me tej se 50 vjetet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Aksionareve, ne baze te legjitatures Shqiptare.

Neni 4

Objekt i veprimtrise se bankes do te jene veprimet bankare te cdo lloji dhe sherbimet bankare te cdo lloji dhe shprehimisht vetem keto veprimtari:

a. i) pranimi i depozitimeve monetare te cdo lloji (ne lek ose ne valute) sic jane current accounts, depozitime ne arken e kursimit, llogari rrjedhese, me afate, me afate te vecanta, me interes ose pa interes, llogari te perbashketa ose me kushte, depozitime te organizmave shteterore, te bankave, te investimeve, portofolio etj, ii) e cila ka per qellim shtimin e kapitalit disponues ne lek ose ne valute, lidhja e cdo lloj kontrate dhe emetimi i huave obligacioni (te cdo lloji).

b. i) dhenia e huajve dhe kredive te cdo lloji
ii) dhenie garancie ne favor te te treteve.
iii) administrimin e huave te kooperimeve dhe pjesmarja ne to.
iv) underwriting per llogari te te treteve dhe pjesemarrje ne to.
v) Leasing dhe blerje te pretendimeve (factoring, forfaiting)

c. i) emetim dhe pagimi ceqesh, ne lek ose ne monedha te huaja.
ii) emetim dhe pagimi i urdhrave nga brenda ose nga jashte
iii) emetim i titujve kreditore

AS± i) depozitim dhe administrim ne pergjithesi i pasurise se -fondeshme dhe te patundeshme te te treteve ose te pasurise se saj irrahe ne vecanti:

W) ruajtja e obligacioneve ose objekteve te cdo lloji ose ne pergjithesi te titujve financiare dhe dhenia me qira te kasetave te sigurimit.

iii) ruajtje ose vlejje per llogari te te treteve cdo lloj letre me vlere dhe te dokumente me vlere ne pergjithesi

iv) shit - blerja e vatules se huaj, e metaleve te cmuara dhe ne pergjithesi te gjithe veprimeve te lejueshme me valuten e huaj.

d. v) shit-blerja e obligacioneve dhe ne pergjithesi te titujve financiare ne tregun monetar dhe tregun e kapitalit.

vi) perfaqesimin e shoqerive te tjera, te cilat kane qellime te njejta ose te peraferta.

e. i) ofrimi i sherbimeve konsultative ne ceshjtje ekonomiko - financiare.

ii) themelimi ose pjesemarrja ne ndermarrje te cdo lloj natyre, bankare ose jo bankare, ne Shqiperi ose jashte shtetit.

iii) themelimi ose pjesemarrja ne shoqeri venture capital dhe ne shoqeri bursash

f. i) ndermjetesime te cdo natyre ne tregjet monetare ose te kapitalit.

ii) themelimi ose pjesemarrja ne shoqeri siguracioni dhe bursash te Financimeve te Portofolio, Administrimi i Mutual Capital, shoqeri konsultative te administratave te ndermarrjeve, aplikime me kompiuter dhe te informatikes, etj.

Veprimtarite e mesiperme kontribojne kryesisht: :

a) ne zhvillimin e eksportit shqiptar

b) ne zhvillimin dhe lehtesimin e pershtatshmerise se industrise, tregetise dhe turizmit ne rrethanat Evropiane.

c) ne zhvillimin e tregut te kapitalit shqiptar

d) ne futjen e kapitaleve te huaja dhe ndermjetesime per financime ne Shqiperi.

e) ne nxitjen e bashkepunimit ndermjet ndermarrjeve shqiptare dhe ato te komunitetit Evropian.

dhe ne pergjithesi cdo veprim bankar ne baze te legjistatures qe do te jete ne fuqi

Per arritjen e ketij qellimi Banka ka te drejten te bashkepusoje me persona juridike ose fizike ose me cilendo tjeter Shoqeri me te njejtin objekt brenda vendit ose jashte vendit qe ka te njejtin qellim.

*Neni 5***KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET**

Kapitali themeltar i Bankes percaktohet ne shumen e 2.000.000 lek (dy milion lek), me qellim qe te krijohet Banka dhe aksionaret qe kontribojne ne kete gje, angazhohen te shtojne kapitalin e bankes ne 200.000.000 lek (dyqind milion lek) menjehere sapo Banka e Shqiperise te jape lejen e funksionimit te bankes. Ne nje rast te tille pjesa tjeter e kapitalit do te derdhet brenda 15 (pesembedhete) diteve nga dita e komunikimit te vendimit te Bankes se Shqiperise e cila do te jape lejen e funksionimi te bankes.

Kapitali ndahet ne 200.000 (dyqind mije) me vlere nominale 1000 (nje mije) lek secila. Aksionet jane te pandashme.

NDRYSHIMI I KAPITALI THEMELTAR*Neni 6***ZMADHIMI I KAPITALIT**

Kapitali themeltar zmadhohet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te jashtezakonshme dhe ndryshimit te statutit.

Kapitali themeltar zmadhohet nepermjet emetimit te aksioneve te reja ose nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese.

Aksionet e reja shlyhen me para ne dore ose me kontribut ne natyre.

Ne rast se zmadhimi i kapitalit behet me kontribut ne natyre, me vendim te Gjykates perkatese, emerohen nje ose me shume eksperte te cilet do te percaktojne vieren e ketij kontributi ne baze te nenit 162 dhe kufizimet e neneve 168, 169 te L. 7638/92.

Aksionaret kane te drejte perpariesie ne nenshkrimin per rritjen e kapitalit. (E drejta e perpariesise)

Zmadhimi i kapitalit themeltar duhet te realizohet brenda pese (5) vjeteve nga dita qe Asambleja e Pergjithshme e Jashtezakonshme miratoi kete zmadhim (neni 153 L. 7638/92)

,x Neni 7

W

ZVOGELIM I KAPITALIT THEMELTAR

Zvogelimi i kapitalit autorizohet ose vendoset nga Asambleja e Pergjithshme e jashtezakonshme. Ne Asamblene e Pergjithshme qe thirret per zvogelimin e kapitalit dorezohet raport i arsyetuar i Keshillit Drejtues duke shpjeguar arsyet qe bejne te detyreshme marrjen e vendimit perkates. Ne te gjitha rastet zvogelimi prek aksionaret ne te njejten mase ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoterojne, ne baze te nenit 164 te L. 7638/92.

Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontrollore te autorizuar, te pakten 45 dite perpara mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme qe thirret per te vendosur mbi kete projekt.

Neni 8

SHLYERJA DHE VERIFIKIMI I KAPITALIT

Nuk mund te merret vendim dhe te realizohet zmadhimi i kapitalit aksionar me para ne dore nese kapitali aksionar i deri tanishem nuk eshte shiyer plotesisht. Ne rast te kundert operacioni i zmadhimit te kapitalit dhe leshimit te aksioneve te reja konsiderohet i pavlefshem, ne baze te nenit 153 L.7638/92. Keshilli Drejtues ne cdo rast te zmadhimit te kapitalit duhet qe ne nje afat tre (3) mujor nga realizimi i zmadhimit te kapitalit te verifikoje depozitimin e kapitalit. Nese kapitali nuk eshte mbuluar plotesisht, atehere Keshilli Drejtues disponon lirshem aksionet e pambuluara tek te tretet ose kapitali aksionar shtohet deri ne shumen e mbulimit te tij.



U
/’ if
• M

KAPITULLI III

AKSIONET

Neni 9

Aksionet jane nominative. Per aksionet do te leshohen tituj transferimi ne baze te ligjit, tipi i te cilave do te vendoset nga Keshilli Drejtues i cili do te percaktoje personat qe do te firmosin titujt. Aksioni nominativ u transferohet te treteve, ne baze te nenit 198 te L. 7638/92. Ne kohen e themelimit te shoqerise ose gjate ekzistences se saj mund te krijohen aksione me perparesi qe kane avantazhe ne raport me te gjitha aksionet e tjera, sipas nenit 148 dhe 149 te L. 7638/92.

Neni 10

Aksionet jane te jane te pandashme kundrejt Shoqerise, e cila njih vetem nje pronar kryesor te nje aksioni. Cdo aksion jep te drejten e nje vote. Ne rastin kur per nje aksion ka me shume se nje zoterues, atehere te drejtat e tyre duhet t'i ushtrojne nepermjet perfaqesuesit te tyre, por nese nuk kane caktuar perfaqesues, aksioni nuk perfaqesohet dhe ushtrimi i te drejtave qe vijne si pasoje e tij pezullohen.

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin njga cdo aksion i ushtron vetem pruresi i tij i ligjshem.

Aksionaret ushtrojne te drejtat e tyre persa i perket drejtorise se Bankes nepermjet Asamblese se pergjithshme te aksionareve.

KAPITULLI IV

ORGANET E SHOQERISE

Neni 11

Ne rastin kur kushdo aksionar deshiron te trasferoje nje pjese ose te gjitha aksionet e tij, eshte i detyruar qe me perpara te beje te njohur me shkrim tek Keshilli Drejtues duke bere te njohur edhe vleren e aksioneve me qellim qe aksionaret e tjere te ushtrojne te drejten e perparise per blerje e ketyre aksioneve. Keshilli Drejtues eshte i detyruar brenda dhjete diteve nga marrja e

1 tejmerimit perkates te lajmeroje me shkrim te gjithe aksionaret e
? Jiere. Aksionaret e tjere kane per detyre qe brenda afatit njezet
jJP-6) ditor te bejne te njohur tek Keshilli Drejtues nese do te
^ushtrojne te drejten e perparemise apo jo. Ne rast se numri i
aksionareve qe interesohen per blerje aksionesh eshte me i madh
se nje do te marrin aksione ne perpjestim me numrin e aksioneve
qe zoterojne. Cdo transferim aksionesh qe behet ne kundertshtim me
kete nen eshte i pavlefshem dhe nuk sjell rezultat te ligjshem si per
aksionaret ashtu edhe per shoqerine.

Nen/12

KESHILLI DREJTUES

Pergjegjesia e drejtimit te bankes i takon Keshillit Drejtues, i cili
zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme dhe perbehet nga tre deri
shtate anetare. Keshilli Drejtues i pare qe do te drejtoje banken
eshte :

1. Salas Michail
2. Remantas Daoulis Nikolaos
3. Bacharopoulos Eleftherios
4. Georganas Georgios
5. Pitsilides Byron

Keshilli drejtues emeron drejtoret e bankes te cilet she e drejtojne.
Drejtoret mund te jene anetare te Keshillit Drejtues ose te trete.

Drejtoret e pare te bankes do te jene :

1. Pitsilides Byron
2. Koutsopoulos Athanasios

Neni 13

Asambleja e Pergjithshme mund te zgjedhe si anetare te Keshillit
Drejtues edhe individe te cilet nuk jane aksionare. Anetaret e

.Keshiliit Drejtues nuk kane pergjegjesi personale kundrejt te treteve She kundrejt aksionareve te bankes. por kane pergjegjesi kundrejt personit Juridik te Shoqerise per detyrat qe u jane ngarkuar.

tKeshilli Drejtues zgjedh kryetarin dhe nenkryetaret e tij. Kryetari kryeson mbledhjen dhe ne mungese te tij, zevendesohet nga nje nenkryetar.

Neni 14

Kohezgjatja e mandatit te anetareve te Keshiliit Drejtues caktohet per nje periudhe 5 vjecare e cila shtyhet deri ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshmeqe do te miratoje tabelat financiare (rezultatet) e vitit financiar qe u mbyll dhe Asambleja e Pergjithshme do te mblidhet detyrimisht brenda gjashte mujorit te pare nga mbyllja e vitit financiar.

Ne rast vdekjeje, shkarkimi nga detyra ose te mungeses te pajustificuar te nje anetari te Keshillit Drejtues nga mbledhjet per tre muaj rrjesht, Keshilli Drejtues mund te zgjedhe zevendes te tij deri ne mbledhjen e pare te Asamblese se Pergjithshme.

Keshilli Drejtues thirret nga Kryetari dhe ne rast se ai nuk ka mundesi ose mungon, thirret nga nenkryetari dhe mblidhet ne seline e bankes te pakten nje here ne muaj ose ne raste te jashtezakonshme mbas kerkeses te te pakten dy (2) keshilletareve, dhe vendimet merren me shumice absolute votash te te pranishmeve dhe te votave te perfaqesuara. Keshilli Administrativ ka kuorum dhe mblidhet ligjerisht kur jane prezent ose perfaqesohen te pakten gjysma plus nje e numrit te anetareve te tij. Anetar i Keshiliit Drejtues qe mungon mund te perfaqesohet ne mbledhjen e Keshiliit Drejtues vetem nga nje anetar i Keshillit Drejtues.

Neni 15

Per diskutimet qe behen dhe per vendimet qe merren, mbahet procesverbal i cili nenshkruhet nga anetaret prezent, ne procesverbal shenohen edhe mendimet e atyre qe nuk jane dakort.

Keshilli Drejtues perfaqeson banke dhe eshte kompetent te vendose per cdo ceshtje qe ka te beje me drejtimin e saj, administrimin e pasurise se saj dhe ne pergjithesi ne arritjen e qelimeve saj. Keshilli Drejtues nuk ka te drejte te marre vendim per ceshtje qe jane ne kompetencat e Asamblese se Pergjithshme.

Keshilli Drejtues mund te ngarkoje me shkrim perfaqesimin e bankes ose dhe te disa komptencave te tij tek nje ose me shume

anetare te tij ose tek te tretet, duke percaktuar njekohesisht dhe f* 1|nasen e pushtetit qe u jep.

?M Tek anetret e Keshillit Drejtues jepet spqerblim i cili percaktohet #^me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 16

KOMITETI I KONTROLLIT (AUDIT COMMITTEE)

Administrata ushtron kompetencat e saj ne bashkepunim me Audit Committee e cila ka tre anetare dhe anetaret e saj, te cilet emerohen nga Asambleja e Pergjithshme e aksionareve dhe kane mandat njevjecar (ne baze te nenit 19 parg. 2 L. 7560.92), Komiteti i pare i kontrollit perbehet nga :

1. Koumoudouros Christos
2. Liapis Kostandinos
3. Amorgianos Dimitrios

Neni 17

Kompetencat e Komitetit Kontrollues (Audit Committee) jane keto:

- a) krijon dhe mbikqyr operacionet llogaritare per Banken si dhe mbikqyr llogarite dhe arkivin e Bankes.
- b) regjistron zbatimin e rregullave dhe informon Keshillin Drejtues te Bankes
- c) shpreh mendimin per ceshtjet qe i ngarkohen nga Keshilli Drejtues i Bankes

Komiteti Kontrollues mblidhet rregullisht cdo kater muaj dhe ne raste te vecanta kur kjo behet e detyrueshme nga Keshilli Drejtues. Vendimet merren me shumice votash te te pranishmeve dhe ndalohet mungesa e anetareve.

Komiteti Kontrollues ka mundesi, mbas kerkeses se saj, te ndihmohet ne vepren e saj nga eksperte te cilet do te emerohen nga Keshilli Drejtues, ne baze te nenit 19 te L. 7560/92.

Neni 18

^ Per ndermarrjen e veprimeve dhe per derdhjen e shperblimeve te anetareve te keshillit drejtues, te drejtuesit dhe te anetareve te <keshillit kontrollues, zbatohen nenet 122-127 te L. 7638/92.

Neni 19

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte i Shoqerise dhe vendos per cdo ceshtje. Vendimet e Asamblese se Pergjithshme jane angazhuese per aksionaret.

Vetem asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme ka te drejten e ndryshimit te statutit, ne lidhje me gjithe dispozitat e saj.

Cdo kusht tjeter konsiderohet i pavlefshem.

Asambleja e Pergjithshme e jashtezakonshme mund te marre vendime te viefshme ne rast se te pranishmit ose aksionaret e perfaqesuar perbejne te pakten 50 % te kapitalit aksionar, gjate mbledhjes se saj te pare. Ne rast se nuk ekziston shumica e duhur e mesiperme, Asambleja e Pergjithshme mund te anulohet per nje dite tjeter por, jo me shume se dy muaj nga dita e mbledhjes se pare, dhe mund te mblidhet pasi jane prezent personalisht ose perfaqesuesit e aksionareve qe perfaqesohen 30% e kapitalit aksionar. Vendimet e Asamblese se Pergjithshme e jashtezakonshme merren me shumicen e 3/4 te votave te pranishemve ose te votave te perfaqesuara.

Neni 20

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E ZAKONSHME

Asambleja e pergjithshme e zakonshme vendos pervec atyre qe referohen ne nenin 128 L. 7638/92.

Asambleja e Pergjithshme merr vendim ne menyre vendimtare per te gjitha ceshtjet qe kane te bejne me banken. Per marrjen e viefshme te vendimeve ne Asamblene e Pergjithshme duhet te jene prezent ose te perfaqesohet 30% e kapitlait aksionar. Ne rast te mos arritjes se kuorumit te Asamblese se Pergjithshme thirret perseri brenda muajit ne te cilen do te mjaftoje 25% i kapitalit aksionar. Vendimet e Asamlese se Pergjithshme merren me shumice absolute te votave prezente ose te perfaqesuara.

y Iksambleja e Pergjithshme e zakonshme mblidhet nje here ne vit ofe brenda gjashte mujorit mbas mbarimit e vitit financiar. Oky afat mund te shtyhet me vendim gjyqi. Asambleja shqyrton dhe ^endos per te gjitha ceshtjet e vitit financiar qe u mbyll. Ajo ushtron kompetencat qe ka ne baze te neneve 105, 108, 109, 123 dhe parag. 3 i nenit 125 te L. 7638/92.

Neni21

Mbledhja e Asamblese se pergjithshme thirret nga keshilli drejtues. Ne mungese te tyre do te thirret nga :

- 1) Nga ekspertet kontrollore te autorizuar
- 2) Nga personi i autorizuar nga gjykata mbas kerkeses te cdo te interesuari per nje rast urgent ose te nje ose disa aksionareve qe te gjitha bashke zoterojne 1/10 e kapitalit.
- 3) Nga likuidatoret

Mbledhja e Asamblese te aksionareve realizohet ashtu sic percaktohet nga ligji.

Nen/22

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme per ceshtjet e rendit te dites behet ashtu sic percaktohet nga ligji. Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme edhe ne rastin kur nuk jane zbatuar procedurat e thirrjes se percaktuar nga ligji nese ne Asambiene e Pergjithshme jane prezent ose perfaqesohen aksionare qe zoterojne shumen e kapitalit aksionar dhe askush nuk mund te thote dicka te kundert. Rendi i dites i asamblese te aksionareve percaktohet nga personi qe therret Asambiene e Pergjithshme. Rendi i dites se asamblese nuk mund te ndryshohet me lajmerim te dyte.

Nen/23

Cdo aksionar/aksionare mund te perfaqesohet vetem nga nje aksionar tjeter ose nga e shoqja/i shoqi.



fJeni 24

Keshilli Drejtues eshte i detyruar te veje ne dispozicion te aksionareve para mbledhjes se asamblese se pergjithshme dokumentacionin qe percaktohet nga neni 136 te ligjit 7638/1992, sipas procedures qe pershkruhet ne kete nen.

Neni 25

Aksionaret qe duan te marrin pjese ne asamble duhet te dorezojne fillimisht ne banke ose aksionet e tyre ose certifikatat e depozitimit te aksioneve nga nje banke tjeter

Neni 26

Ne rast se nje aksion i takon me shume se nje personi, per cdo shkak dhe arsye, ata jane te detyruar te percaktojne perfaqesuesin e tyre te perbashket i ciii do te ushtroje te drejtat e tyre aksionare ne pergjithesi

Neni 27

Anetaret e keshillit drejtues dhe ekspertet kontrollore te autorizuar mund te marrin pjese ne te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme me vota konsultative. Ata kane vote vendimtare kur kane vetine e aksionarit.

Neni 28

Emrat e atyre qe marrin pjese ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme shenohen ne «Librin e pjesemarrjes». Ecuria e mbledhjeve regjistrohet ne procesverbalet.

Neni 29

Ne Asamblene e Pergjithshme kryeson kryetari i Keshillit Administrativ dhe kur mungon ai, kryeson nenkryetari ose

»

perfaqesuesi nga anetaret e pranishem. Detyrat e sekretarit i zbaton ai qe caktohet nga kryetari.

Nen/30

Duke filluar qe nga momenti i Lajmerimit te Asamblese se Pergjithshme te zakonshme vjetore, cdo aksionar ose perfaqesuesi i tij qe do ta perfaqesoje ne asamble, ka te drejte qe ne seline e bankes te informohet per te gjitha ceshtjet qe parashikohen ne nenin 143 L. 7638/92 dhe sidomos per keto :

Regjistrimi, bilanci vjetor, lista e anetareve te Keshillit Administrativ, si dhe listen e anetareve te Keshillit Drejtues.

Referimet e Keshillit Administrativ dhe te eksperteve Kontabel te autorizuar.

Shumen e sakte te shperblimit qe marrin personat e mesipern.

Neni31

Cdo aksionar ka te drejte te informohet ose te marre kopje te listes se aksionareve dhe te anetareve te keshillit drejtues te bankes pesembedhjete (15) dite me pare se mbledhja e Asamblese se Pergjithshme.

Neni32

Ne rast te refuzimit te pjesshem ose te plote te se drejtes, se aksionarit nga ana e bankes, per t'u informuar, e drejte qe i jepet nga nenet e mesiperme, aksionari qe konsideron se preket nga ky veprim, ka te drejte t'i drejtohet Gjykates.

Nen/33

TE DREJTAT E PAKICES

Aksionare te cilet perfaqesoje nje te dhjeten e kapitalit kane mundesi te therrasin asamble te jashtezakonshme duke percaktuar dhe ceshtjet e rendit te dites. Keshilli Drejtues eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjithshme te kerkuar, pervec rastit kur ka

nje arsye shume te rendesishme. Aksionaret qe perbejne nje te phjeten e kapitalit aksionar mund t'i drejtohen gjyqit qe te kerkojne fcontrollin e ekzistences se arsyes se rendesishme dhe thirrjen e asamblese me vendim gjyqi.

Me kerkese te aksionareve qe perfaqesojne nje te dhjeten e kapitalit aksionar, kryetari i Asamblese ka mundesi te anulloje per nje here te vetme marrjen e vendimit te asamblese se pergjithshme te zakonshme ose te jashtezakonshme duke percaktur njekohesisht dhe ditën e mbledhjes per marrjen e vendimit, dite e cila nuk mund te jete se 30 dite me pas nga dita e anulimit te mbledhjes se pare.

KAPITULLI VI

KONTROLLI I SHOQERISE

Nen/34

KONTROLLORET E NENIT 37 L. 7560/92

Asambleja e Pergjithshme do te emeroj nje kotrollor i cili ka miratimin e Bankes se Shqiperise dhe ka keto veti:

Ndihmon ne mbajtjen e llogarive te bankes ne menyre qe ato te jene sipas parimeve baze te kontabilitetit.

Pergatit raportin vjetor te te dhenave ekonomike (bilanci, llogaria e fitimeve dhe e humbjeve dhe te dokumenteve te tjera qe kane lidhje me to) dhe shpreh mendimin nese te dhenat ekonomike reflektojne realitetin e gjendjes ekonomike te Bankes.

Informon Keshillin Administrativ dhe Banken e Shqiperise ne lidhje me ndonje parregullsi te mundeshme qe u vu re ne shkembimet, procedurat, arkivet ose llogarite e bankes te cilat do te mund te conin ne ekzistencen e humbjeve per banken.

Neni35

Ne rast te mos kryerjes me saktesi te detyrave te tij, kontrollori i autorizuar mund te pezullohet nga detyrat e tij me vendim Gjyqi i cili mblidhet dhe vendos me procedure urgjente.

INen/36

- ^ Eksperti kontrollues i autorizuar ka per detyre te mbikqyre llogarite vjetore te cilat duhet te jene te perpiluara ne baze te rregullave nderkombetare te pranuar dhe te shprehin me saktesi rezultatet e periudhes ushtrimore si dhe te japin me sinqeritet dhe rezultatit e dale ne fund te vitit Financiar. Eksperti kontrollues ka dhe kompetencat qe percaktohen nga nenet 178, 179, 180 dhe 182 te L. 7638/92.

Neni37

Shoqeria mban ne zyrat e saj librat qe kerkohen nga Ligji, ku do te mbahen llogarite vjetore, tabelat financiare vjetore, bilancet ekonomike vjetore, raportet ekonomike vjetore, ne te cilat duhet te perfshihet dhe cdo gje tjeter qe parashikohet nga ligji.

Librat zyrtare te bankes dhe tabelat financiare vjetore, bilancet financiare dhe raportet financiare vjetore duhet te mbahen si ne gjuhen shqipe ashtu edhe ne greqisht

Neni38

Viti financiar ka kohezgjatje 12 muaj, duke filluar nga data 1 Janar deri ne daten 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtohet viti i pare financiar qe fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne gjykate dhe mbaron me 31.12.199 .

Ne fund te cdo viti financiar Keshilli Drejtues ben Regjstrimin (inventarin) dhe llogarite vjetore ne baze te dispozitave te ligjit ne fuqi per Kontabilitetin, si dhe perpilon raportin per Administrimin.

Nen/39

REZERVAT E DOMOSDOSHME

Krijohet kapital rezervues i domosdoshem i cili krijohet nga mbajtja e nje perqindje te pakten 5% nga fitimet neto te shoqerise pasi me perpara jane zbritur humbjet e mundeshme te viteve te meparshme. Kjo procedure pushon se qeni e detyrueshme kur

dhuma e kapitalit te rezervuar arrin ne masen e 1/10 se kapitalit te sjhbqerise.

Neni 40

NDARJA E FITIMEVE

Fitimet qe do te ndahen, perbejne fitimet e Vitit Financiar mbasi do te jene zbritur rezervat dhe humbjet e mundeshme te viteve te meparshme, ne baze te nenit te mesiperm.

Neni 41

PERCAKTIMI I DEVIDENTEVE

Mbas miratimit te bilancit vjetor dhe regjistrimit e shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme cakton shumen qe do te ndahet tek aksionaret me formen e Devidenteve, ne baze te neneve 215, 216 te L. 7638/92 (ne baze te Kapitalit Aksionar)

KAPITULLI V

Neni 42

PRISHJA

Banka priset nese ka mbaruar kohezgjatja e saj ose ne qofte se ka shpallur falimentim.

Neni 43

LIKUIDIMI

Likuidimi i bankes behet ne baze te dispozitave qe percaktohen nga ligji.



Banka ben likuidimin e saj, qe ne momentin e prishjes se saj per pctalloj arsye, me perjashtim te rastit te nenit 10 te L. 7638/92. Ne emertimin e bankes ne stadin e likuidimit, perfshihet edhe shprehja «ne* likuidim ». Ky tregues si dhe emri i likuidatorit duhet te shenohen ne te gjitha veprimet dhe dokumentat qe leshon shoqeria tek te tretet.

KAPITULLI VI

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 44

Per ceshtjet qe nuk parashikohen nga statuti dhe gjate themelimit te bankes (akti i themelimit) zbatohen dispozitat ne fuqi te ligjit per Shoqerite Anonime pa oferte publike ne nderthurje me ligjin per bankat.

KAPITULLI VII

DISPOZITAT E FUNDIT

MBULIMI I KAPITALIT AKSIONAR

Neni 45

Kapitali aksionar mbulohet si me poshte :

A.

1. Banka e Piraeus	45%	900.000 lek
2. Unico	15%	300.000 lek
3. Piraeus Finance	40%	800.000 lek

B. Aksionaret angazhohen te zmadhojne kapitalin aksionar ne 200.000.000 lek ne propocion me pjesemarrjen e secilit prej tyre, ashtu sic shkruhen me larte, menjehere mbasi Banka e Shqiperise

te. komunikojë vendimin aprovues dhe jo me vonë se oesembdhjete dite me pas nga dita e komunikimit të vendimit.

w'-\$*.
f' *

Nen/46

Palet pjesëmarrëse japin porosi të vecante dhe autorizojnë z. Andon Kokoli të dorëzojë në autoritet publike këtë statut për miratim dhe në përgjithësi të kryejë të gjitha procedurat e ligjshme për të përfunduar themelimin e bankës. Personi i mesipër i autorizuar, për llogari të gjithë pjesëmarrësve, thirret të përpilojë dhe të nënshkruajë çdo lloj dokumenti dhe deklaratë që do të jetë e nevojshme për përfundimin e regjistrimit të ligjshëm të statutit dhe për themelimin e ligjshëm të bankës.

Gjithashtu jepet porosi e vecante dhe autorizim tek z. Andon Kokoli të nënshkruajë për llogari të bankës dhe çdo gjë tjetër që do të jetë e nevojshme kundër autoriteteve përkatëse dhe vecanerisht regjistrimin e shoqërisë në policinë financiare.

Nem47

Titulli i Bankës caktohet "**TIRANA BANK INTERNATIONAL BANKING CORPORATION**", i cili përbahet edhe në vullen e saj sipas nenit 57 L. 7560/92.

Sterna e bankës do të jetë si më poshtë :

Nen/48

Shtetësia shqiptare nuk përbën kusht për fitimin e vetisë së anëtarit të Keshillit Drejtues, të Drejtuesit ose të anëtarit të keshillit të kontrollit.



Nen/49

/Jb'i Ky statut ekziston ne kater kopje ne gjuhen Shqipe dhe pasi u ir perpilua dhe u lexua, u nenshkrua nga Aksionaret e Bankes.

Nen/50

DISPOZITA E FUNDIT

Kjo Banke do te filloje te funksionojë me kusht miratimin e veprimtarise se saj nga autoritetet perkatese shqiptare, ne baze te legjistacionit ne fuqi dhe vetem me kete kusht.

ORTAKET THEMELUES

1. Piraeus Finance - perfaqeuar nga z. Michail Salas (i cili perfaqesohet nga z. Nikolaos Daoulis Remantas, sipas prokures me nr. 29651 rep. , date 1.11.1995 te redaktuar nga Noteri i Athines: Vasilios Chronis).

2. Bank of Piraeus - perfaqesuar nga z. Michail Salas (i cili perfaqesohet nga z. Nikolaos Daoulis Remantas, sipas prokures me nr. 29652 rep., date 1.11.1995 te redaktuar nga Noteri i Athines: Vasilios Chronis).

3. Unico Corp. - perfaqesuar nga z. Nikolaos Daoulis Remantas
Nr. pass H 36726

Tirane me

REPUBLIKA E SHQIPERISE

I

DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. t Rep. /\$3~36

Nr. Kol. \$ 6 ^

V E R T E T I M

Sot ne daten _____ ne zyren e noterise ne Tirane u paraqiten para meje noteres ortaket e Shoqerise Tregetare "BANKA E TIRANES SKA.", ZOTERINJTE E MEPOSHTEM :

1. **Pireaus Finance** - perfaqesuar nga Michail Salas (i cili perfaqesohet nga z. Nikolaos Daoulis Remantas, sipas prokures me nr. 29651 rep., date 1.11.1995 te redaktuar nga Noteri i Athines: Vasilios Chronis).

2. **Bank of Pireaus** - perfaqesuar nga Michail Salas (i cili perfaqesohet nga z. Nikolaos Daoulis Remantas, sipas prokures me nr. 29652 rep., date 1.11.1995 te redaktuar nga Noteri i Athines: Vasilios Chronis).

3. **Unico Corp.** - perfaqesuar nga z. Nikolaos Daoulis Salas Nr. pass H 367626

madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u vura ne dijeni nga leternjoftimet personale qe ata mbajne me vete, te cilet me deklaruan se kete statut e nenshkruan me vullnetin e tyre te lire cka e vertetoj edhe une si notere me nenshkrimin tim .

NOTERE



Supress *Ysolu*